

**MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Rrëshen**, me objekt: *“Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, aktivitetin ekonomik e financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve të qëndrueshme, dhënien me qira të objekteve, prokurimet me fonde publike, taksat dhe tarifatat vendore, etj.”*, lloji i auditimit: *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 138, datë 26.09.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”*, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 621/9, datë 26.9.2014, i ka rekomanduar z. Ndue Gega Kryetar i Bashkisë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Rrëshen ka zbatuar pjesërisht rekomandimet e dërguara nga KLSH në auditimin e mëparshëm, në kundërshtim me urdhrin e Kryeministrit nr. 70, datë 18.04.2006 *“Për masat në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Auditit të Brendshëm dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion, në Këshillin e Ministrave, në institucionet në varësi të Kryeministrit e të ministrive, trajtuar “më hollësisht në faqen 9, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1.1. Rekomandimi: Bashkia Rrëshen të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të pazbatuara, të dërguara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, me shkresën nr. 150/9, datë 30.06.2012, rikërkuar me shkresën nr. 1336/21, datë 29.03.2013.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Bashkia Rrëshen nuk ka një plan për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit ku përcaktohet qëllimi strategjik me objektivat e arritjes së tyre.

Veç kësaj nuk është hartuar dhe dërguar pranë Njesisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit pranë Ministrisë së Financave“ Pyetësori i vetvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit” për vitin 2012 dhe 2013, në kundërshtim me nenin 19 dhe 29 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe shkresave përkatëse të Ministrisë së Financave, trajtuar më hollësisht në faqet 12-13, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.1.Rekomandim: Të hartohet plani për ngritjen e sistemit dhe kontrollit, si dhe metodologjia për zbatimin e tij, të hartohet dhe të miratohet Kodi Etik, të identifikohet dhe të krijohet regjistri i riskut, të futen procedurat antikorrupsion etj,

në zbatim të nenit 8, 10, 12, 20 etj, të ligjit 10,296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Bashkia Rrëshen është penalizuar nga gjykata për largime nga puna të punonjësve për zgjidhje të kontratës së punës, në kundërshtim me ligjin nr.7961, datë 11.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar. nenin 153 dhe 154, duke rënduar padrejtësisht shpenzimet e Institucionit **në vlerën 7,859,470 lekë**. Pavarësisht ndjekjes në të gjitha shkallët e gjykimit dhe kontestimeve nga ana e NJQV të vendimeve të gjykatave për dëmshpërblimet për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, përgjegjësia është tërësisht e institucionit i cili nuk ka analizuar të gjitha vendimet që sjellin dëm efektiv për buxhetin e shtetit dhe nuk ka kërkuar nxjerrjen e përgjegjësive administrative ndaj shkaktarëve, trajtuar më hollësisht në faqet 17-19, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

3.1.Rekomandim: Bashkia Rrëshen, të nxjerrë përgjegjësit për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare të punonjësve me institucionin, për shkaqe të pa argumentuara dhe të pambështetura në dispozitat ligjore në fuqi, pasi për shkak të këtyre veprimeve, institucioni detyrohet të ekzekutojë vendime gjyqësore duke paguar shumën 7,859,470 lekë.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi:

-Autoriteti kontraktor nuk ka botuar njoftim për lidhjen e kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike, në kundërshtim me kreun e parë, pika 3, germa “ç” Botimi i njoftimit të fituesit dhe njoftimi i kontratës së lidhur, e VKM, ku shprehet se: Autoriteti kontraktor dërgon për botim në Buletinin elektronik të Njoftimeve Publike dhe publikim në faqen e internetit të APP-së njoftimet e fituesit, në përputhje me nenin 58, të LPP-së.

-Në dosjen e procedurave të prokurimit, nuk ka kërkesë për prokurim, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", ndryshuar, Kreu V.

-Në të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara nga autoriteti kontraktor nuk ka urdhër për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, Kreu II pika 2/c, Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 për "Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" , nenet 15 dhe 22.

-Nuk janë dhënë argumentime mbi vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, i ndryshuar. Kërkesa të tilla kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, duke paguar më shumë për diferencat në kualifikimin e ofertuesve, pa arritur efektivitet ekonomik në realizimin e prokurimit.

-Nuk ka dokument/procesverbal për miratimin e Dokumenteve të Tenderit nga Njësia e Prokurimit të Institucionit, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, Neni 38, 39, 41, VKM nr. 1, date 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", e ndryshuar, Kreu V pika 1/c,2/a

dhe Ligji Nr. 10296, datë 8.7.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" , Neni 15, 22.

-Mungon projekti i zbatimit, mbi të cilat janë bërë përlogaritjet e zërave të preventivit, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, Kreu V, pika 1/ç; Ligji për "Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" nr. 10296, datë 08.07.2010, neni 15, 22.

4.1. Rekomandim: Bashkia Rrëshen nëpërmjet strukturave përgjegjëse të forcojë kontrollin e brendshëm në lidhje me procedurat e planifikimit dhe prokurimit, konkretisht në parashikimin e nevojës për prokurim, kërkesë për prokurim dhe miratimi i saj; hartimi dhe miratimi i urdhrat për zgjedhjen e procedurës së prokurimit, ngritjen e komisionit të vlerësimit, fondit limit dhe specifikimeve teknike; përgatitja, miratimi dhe hedhja në sistem e dokumenteve të tenderit; ngritja e komisionit dhe vlerësimi i ofertave; miratimi i raportit narrativ përmbledhës; njoftimi i ofertës fituese; përgatitja, miratimi, nënshkrimi i kontratës dhe pagesa e sigurimit të saj, mbikëqyrja e zbatimit të kontratës, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve, mallrave dhe shërbimeve, likuidimi i transaksioneve dhe zbatimi i detyrimeve kontraktuale.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Autoriteti kontraktor nuk ka bërë arkivimin e procedurës së prokurimit në sistem, në kundërshtim me udhëzimin e APP-së.

5.1. Rekomandim: Bashkia Rrëshen të marrë masat që, me përfundimin e procedurave të prokurimit, të kryhe inventarizimi e brendshëm i dosjeve, në përputhje me nenin 30, Modeli nr. 8 "Norma Teknike Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat".

Në vijimësi

6. Gjetje nga Auditimi: Në vendimet administrative të nxjera nga Bashkia Rrëshen, nuk janë ndjekur afatet kohore, për vendosjen e sanksioneve (vendosjen e gjobave dhe nxjerrjen e urdhrave të prishjes së ndërtimeve të pa ligjshme), në kundërshtim me nenin 13 të ligjit nr. 9780 datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit" i ndryshuar.

6.1. Rekomandimi: Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor, të marrë masa në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, për të evidentuar e kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme ndërtimet pa leje, duke aplikuar gjoba dhe masa pasvijuese ndëshkimore ndaj subjekteve ndërtuese të kundërligjshëm, me qëllim zbatimin e ligjit dhe zhvillim e territorit, në zbatim të nenit 5, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit" i ndryshuar.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 08.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative", pjesa e VI, kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 20.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit

Publik”, kapitulli IV (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **4,413,604 lekë**.

1. Gjetje nga auditimi:

-Autoriteti kontraktor nuk ka zbatuar nenin 27 “Dëmshpërblimi për vonesat” dhe nenin 34 “Dëmet e Likuidueshme për Vonesën në Mbarimin e Punimeve”, pika 34.1, germa “a”, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës, duke shkaktuar dëm ekonomik nga moszbatimi i penaliteteve, në vlerën **3,163,258 lekë**, nga operatori ekonomik “Kthella”, në zbatimin e punimeve të kontratës me objekt “Rehabilitim i zonave rreth pallateve bashkia Rrëshen”.

-Autoriteti Kontraktor, para pagimit të faturës së mallit (gazoil) nuk ka kontrolluar përqindjen, e rritjes apo të uljes, të çmimit të bursës sipas Reuters, nëse është e njëjtë me atë të premtuar në ofertë, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu VIII ekzekutimi i kontratës, pika 2/c, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **9,335.40 lekë**, në zbatimin e kushteve tëkontratës me objekt “Furnizimi me karburant Gazoil D1 bashkia Rrëshen”, nga operatori ekonomik “K...”.

-Në situacionin përfundimtar, janë përfshirë vlera e pajisjeve me TVSH, në kundërshtim UKM nr.2 datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” dhe UKM nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, për rrjedhojë vlera e tvsh **33,202 lekë** është përfituar padrejtësisht nga operatori ekonomik “K...” në zbatimin e kontratës me objekt “Sistemime, ndërtim trotuaresh e lulishtesh qyteti Rrëshen”.

-Kanë rezultuar diferenca në punimet e realizuara në krahasim me volumet e përshkruara në librezën e masave dhe situacionin përfundimtar në zërin “Shtresë stabilizanti t=5cm”, në vlerën **235,200 lekë**, në zbatimin e kontratës me objekt “Ndërtim rruge dhe trotuare në qytetin Rrëshen (tek ish shatërvani dhe rruga e Arbrit” dhe në zërin “shtresë asfaltobetoni”, në vlerën **164,436 lekë**, në zbatimin e kontratës me objekt “Rikonstruksion i rrugëve në qytetin Rrëshen”, në kundërshtim me UKM nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, nga operatori ekonomik “K...”.

1.1. Rekomandimi: Bashkia Rrëshen të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbartimor për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës **3,605,431 lekë**, nga operatori ekonomik “K...”.

-diferencë çmimi në vlerën **9,335.40 lekë**, në zbatimin e kontratës me objekt “Furnizimi me karburant Gazoil D1 bashkia Rrëshen”.

-përfituar padrejtësisht vlerën e tvsh **33,202 lekë** për pajisjet, nga operatori ekonomik “K...”, në zbatimin e kontratës me objekt “Sistemime, ndërtim trotuaresh e lulishtesh qyteti Rrëshen”.

-diferenca në punimet e realizuara në krahasim me volumet e përshkruara në librezën e masave dhe situacionin përfundimtar në vlerën **399,636 lekë**, në zbatimin

e kontratës me objekt “Ndërtim rruge dhe trotuare në qytetin Rrëshen (tek ish shatërvani dhe rruga e Arbrit” dhe “Rikonstruksion i rrugëve në qytetin Rrëshen”.

Brenda 31.03.2015.

2. Gjetje nga auditimi: Në situacionin përfundimtar të objektit “*Rikonstruksion i qendrës shëndetësore Malaj -Qendër bashkia Rrëshen*”, është situacionuar zëri “tuba e rekorderi” pa sasi në vlerën **5,600 lekë**, në kundërshtim me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011 Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

2.1. Rekomandimi: Bashkia Rrëshen të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbarimore, arkëtimin e vlerës **5,600 lekë**, nga operatorit ekonomik “E...” shpk, e cila përfaqëson vlerën e përfituar për punime të pakryera, sipas kontratës me objekt “Rikonstruksion i qendrës shëndetësore Malaj -Qendër Bashkia Rrëshen”.

Deri me 31.12.2014.

3.Gjetje nga auditimi: Në preventivin e punimeve, pjesë e dokumenteve të tenderit me objekt “Rehabilitim i zonave rreth pallateve dhe rrethim i Ambulancës A1 Malaj”, është kërkuar nga autoriteti kontraktor zëri i punës “Skelë metalike me tubo-8m (Shtyllat)”, në shumën **prej 29,160 lekë**, i cili nuk duhej vendosur në preventiv, pasi është absurditet që për lyerjen e çdo shtylle të ndriçimit elektrik të ngrihej një skelë metalike, por duhej kërkuar në DST në “Disponimi i mjeteve” , mjetei “autovinç ose vinç –kullë” për lyerjen e shtyllave, në kundërshtim me UKM nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

3.1.Rekomandimi: Bashkia Rrëshen të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i vlerës **29,160 lekë**, nga z. A.M. në cilësinë e hartuesit të preventivit, pasi ka hartuar preventivin në kundërshtim me UKM nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

Deri me 30.11.2014.

4. Gjetje nga auditimi:

-Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar ofertë të vlefshme dhe ka shpallur fitues ofertën e operatorit ekonomik “Z.P.”, me çmim më të lartë se sa fondi limit i parashikuar, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **459,608 lekë**, në tenderin me objekt “Blerje ushqimesh për institucionet shkollore dhe parashkollore”, në kundërshtim me ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 52, 53/1, 54, 55, 56 dhe VKM nr.1, datë 10.01.2007, "Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Kreu V, pika 4.

-Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka vlerësuar objektivisht ofertën e operatorit ekonomik “I...O...”, e cila rezulton me një vlerë më të ulët se oferta e shpallur fituese, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **266,755 lekë**, në tenderin

e zhvilluar në vitin 2012 me objekt “Blerje kancelarish”, në kundërshtim me ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 52,53/1, 54,55,56 dhe VKM nr.1,datë 10.01.2007, "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, Kreu V, pika 4.

4.1.Rekomandimi: Bashkia Rrëshen të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i vlerës **726,363 lekë**, nga J.P. z.M.P. (duke dërguar detyrimin në Bashkinë Rrubik ku punon aktualisht) dhe A.Sh. në cilësinë e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, pasi kanë shqyrtuar dhe vlerësuar oferat, në kundërshtim me ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Neni 52, 53/1, 54, 55 , 56 dhe VKM nr. 1,datë 10.01.2007, "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, Kreu V,pika 4.

Deri 31.03.2015.

5. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2013 dhe 6 mujorin e parë të vitit 2014, nuk është arkëtuar vlera e qirasë **29,050 lekë**, nga L.B. në kundërshtim me kontratën e qirasë nr.118, datë 01.03.2012 për dhënie me qira në zonën kadastrale nr. 3224, të objektit “Godina e ish komitetit ekzekutiv”.

5.1. Rekomandimi: Bashkia Rrëshen të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e vlerës **29,050 lekë**, nga Personi fizik L.B. pasi nuk është shlyer vlera e qirasë për vitin 2013 dhe 6 mujorin e parë të vitit 2014, për objektin e marrë me qira nga Bashkia Rrëshen, sipas kontratës së qirasë nr.118, datë 1.3.2012.

Deri me 31.12.2014.

6. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2013 dhe 6 mujorin e parë të vitit 2014, nuk është arkëtuar vlera e qirasë **18,000 lekë** nga operatori ekonomik D.K. në kundërshtim me kontratën e qirasë nr.111, datë 01.03.2012.

6.1. Rekomandimi: Bashkia Rrëshen të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i vlerës **18,000 lekë**, nga Personi fizik D.K. pasi nuk është shlyer vlera e qirasë për vitin 2013 dhe 6 mujorin e parë të vitit 2014, për objektin e marrë me qira nga Bashkia Rrëshen, sipas kontratës së qirasë nr.111, datë 01.03.2012.

Deri me 31.12.2014.

C. MASA ADMINISTRATIVE

I. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve për periudhën 01.01.2012 deri më 30.06.2014, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet përkatëse, vërejtjeve të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenin 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” të ndryshuar, pikës 3, kreu X të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, neni 7, pika 2,3/a, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270,

datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, i rekomandojmë Drejtorit të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo me rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) për punonjësit:

1. Z. N.G. me detyrë Kryetar i Bashkisë Rrëshen, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

Për arsye se:

-Autoriteti kontraktor nuk ka zhvilluar procedurë prokurimi për objektin mbikëqyrje punimesh në objektin “Meremetime dhe lyerja e objekteve të shkollave të bashkisë Rrëshen”, “Rehabilitim i pallateve përgjatë shëtitores “Gjergj Fishta”, “Ndërtim trotuari nga ura e Sotirit deri tek ish Drejtoria e Bujqësisë” dhe “Rehabilitim i zonave rreth pallateve qyteti Rrëshen”, në kundërshtim të hapur me udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011 Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, nenet 1 “Objekti dhe qëllimi”, 2 “Parimet e përzgjedhjes”, 4 “Fusha e zbatimit” dhe 29 “Procedurat standarde të prokurimit”, të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, pasi autoriteti kontraktor, në përcaktimin e fituesit, nuk ka zbatuar asnjë nga procedurat e parashikuara në këtë ligj, duke cënuar parimet e përzgjedhjes së fituesve të kontratave publike, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të ofertuesve dhe parimin e transparencës në procedurat e prokurimit, duke favorizuar kështu një operator ekonomik të caktuar.

2. zj. L.M., në cilësinë e specialistit të Njësisë së Prokurimeve

3. zj. Sh.B., në cilësinë e specialistit të Njësisë së Prokurimeve

4. z. T.P., në cilësinë e specialistit të Njësisë së Prokurimeve

5. z. E.N., në cilësinë e specialistit të Njësisë së Prokurimeve

6. z. A.M., në cilësinë e specialistit të Njësisë së Prokurimeve

7. z. F.Ll., në cilësinë e specialistit të Njësisë së Prokurimeve

8. zj. F.F., në cilësinë e specialistit të Njësisë së Prokurimeve

Për arsye se:

-Në vitin 2013 dhe 6-mujorin e I-rë 2014, autoriteti kontraktor nuk ka dorëzuar në Agjencinë e Prokurimit Publik raporte për veprimtarinë e tij të prokurimit sipas formatit dhe përmbajtjes së përcaktuar në rregullat e prokurimit, në kundërshtim me pikën 4, të nenit 12 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

-Nuk është bërë vlerësimi nga grupi i punës për përlllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike ose njësia e prokurimit, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu II pika, 2/c, Kreu V, pasi nuk është bërë analiza e tregut, vlerësimin e objektit të prokurimit, nuk janë studiuar çmimet e botuara nga INSTAT, apo çmime zyrtare të institucioneve të tjera; çmimet e tregut; çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; çmimet ndërkombëtare, të botuara.

- Përcaktimi dhe vendosja e kriteve të kualifikimit nga autoriteti kontraktor (NJP), është kryer në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Kryesisht,

është konstatuar vendosja e kriterëve të gabuara për kualifikim, për sa i përket “kapaciteteve teknike”, si psh: “Kërkesa për mjete e makineri, të cilat nuk përputhen me llojin dhe përmasat e objektit”; “Kërkesa për një numër më të madh punonjësish sesa nevojiten”; “Kërkesa për licenca profesionale, të cilat tejkalojnë përmasat e objektit”, etj.

Vendosja e këtyre kriterëve të kualifikimit, ka kufizuar numrin e operatorëve ekonomikë dhe bie në kundërshtim me nenin 1 dhe nenin 2, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi ndikojnë drejtpërdrejt në krijimin e kushteve për shmangien nga konkurrenca ose favorizimin e subjekteve të caktuara, duke cënuar në këtë mënyrë parimet themelore të ligjit për prokurimin publik.

- Nuk janë dhënë argumentime mbi vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se, për vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në Ligjin e Prokurimeve Publike dhe në këto rregulla, njësia duhet të argumentojë me hollësi vendosjen e tyre, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës, duke nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik, veçanërisht biznesit të vogël. Kërkesa të tilla kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, duke paguar më shumë për diferencat në kualifikimin e ofertuesve, pa arritur efektivitet ekonomik në realizimin e prokurimit.

9. z.J.P., në cilësinë e anëtarit dhe kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

10. z. M.P., në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

11. z. A.Sh., në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

12. z. V.K., në cilësinë e anëtarit dhe kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

13. zj. V.Gj., në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

14. z. V.T., në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

15. z. Gj.R., në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

Për arsye se:

-Kanë shqyrtuar ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomik në tenderat e zhvilluara për periudhën 2012, 2013 dhe 6- mujorin e parë 2014, në kundërshtim me ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 53 “shqyrtimi i ofertave”, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar kreu V “zhvillimi i procedurave”, duke kualifikuar ofertues të cilët nuk plotësojnë kriteret për kualifikim ose kanë skualifikuar ofertues të cilët i plotësojnë kriteret e kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në DST, si dhe ka përdorur dy standarde gjatë vlerësimit të ofertave.

II. Për Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik Vendor.

Në mbështetje të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, Kreu III-të “Sanksionet” neni 15, i propozohet Kryeinspektorit të Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor, të vlerësojë dhe të marrë masa administrative për punonjësit:

1. z. A.M., në cilësinë e hartuesit të preventivit të projektit të zbatimit.

Për arsye se:

-mungon projekti i zbatimit, mbi të cilat janë bërë përllogaritjet e zërave të preventivit në rikonstruksionet “Meremetime dhe lyerja e objekteve të shkollave të bashkisë Rrëshen”, “Rikonstruksion i qendrës shëndetësore Malaj-Qendër bashkia Rrëshen”, “Rehabilitim i pallateve përgjatë shëtitores “Gjergj Fishta”, “Ndërtim trotuari nga ura e Sotirit deri tek ish Drejtoria e Bujqësisë” dhe “Rehabilitim i zonave rreth pallateve qyteti Rrëshen”, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, Kreu V, pika 1/ç; Ligji për "Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" Nr. 10296, datë 08.07.2010, neni 15, 22. VKM nr. 1, date 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, Kreu V pika 1/ç, trajtuar në faqet 23-86, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2. z. M.P., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin “Rehabilitim i zonave rreth pallateve Bashkia Rrëshen”.

Për arsye se:

-nuk ka paraqitur dosje teknike në autoritetin kontraktor sipas kontratës së mbikëqyrjes nr. 4463, datë 27.10.2013 të nënshkruar ndërmjet z. Mëhill Pacuku në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve dhe Titullarit të Autoritetit Kontraktor .

3. z. P.P., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin “Rikonstruksion i qendrës shëndetësore Malaj -Qendër bashkia Rrëshen”,

4. z. B.Gj., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në “Meremetime dhe lyerja e objekteve të shkollave të bashkisë Rrëshen”.

Për arsye se:

Në dosjet teknike mungojnë këto dokumente: Projektin e zbatimit të firmosur nga projektuesi dhe të konfirmuar nga bashkia, Plani-organizimin e punimeve të ndërtimit, Certifikatat profesionale (licencat), të pjesëmarrësve në procesin e ndërtimit (shoqërisë sipërmarrëse dhe mbikëqyrësit), Akti i dorëzimit të dokumentacionit para fillimit të punimeve, Libri i kantierit, Pasqyrën e realizimit të punimeve (formati tip), Provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve të përdorura, Aktet e inspektimeve të kryera gjatë zbatimit të punimeve (formati tip), Siguracionin e punonjësve, të cilët punojnë në objekt, kontratë për kolaudimin e punimeve me kolaudatorin, deklaratën e kolaudatorit për konfliktin e interesit, në kundërshtim me udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011 Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar”.

D. MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në nenet 37 dhe 144, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, ti kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Rrëshen, që të fillojë procedura e masës disiplinore, për punonjësit:

“Zgjidhje e kontratës së Punës”.

1. **Për z. J.P.**, me detyrë Inspektor i Aseteve Publike, në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave,
2. **Për z. A.Sh.**, me detyrë ish Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Komunitare, në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave,
3. **Për z. V.K.**, me detyrë specialist, në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave

Për arsye se:

-Kanë shqyrtuar ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomik në tenderat e zhvilluara për periudhën 2012, 2013 dhe 6- mujorin e parë 2014, në kundërshtim me ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 53 “shqyrtimi i ofertave”, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar kreu V “zhvillimi i procedurave”, duke kualifikuar ofertues të cilët nuk plotësojnë kriteret për kualifikim ose duke skualifikuar ofertues të cilët i plotësojnë kriteret e kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në DST, si dhe ka përdorur dy standarde gjatë vlerësimit të ofertave.

4. **Për z. M.P.**, me detyrë specialist i punësuar në Bashkinë Rrubik, me profesion inxhinier ndërtimi, në cilësinë e kryerjes së detyrimeve zyrtare, pa patur të drejtë ligjore ose marrëdhënie punësimi apo sipërmarrje shërbimi,

Për arsye se:

-Për periudhën viti 2012, viti 2013 dhe 6 mujori i parë i vitit 2014, pa lidhur kontratë pune, pa patur asnjë marrëdhënie dhe pa njoftuar apo lejuar nga Bashkia Rrubik, është punësuar në Bashkinë Rrëshen në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, si specialist i jashtëm, në procedurat e prokurimit që ka zhvilluar Bashkia Rrëshen.

- Ka lidhur kontratë pune si mbikëqyrës i punimeve me kohë të plotë, për kontrata pune, në objektet që ka rikonstruktuar Bashkia Rrëshen, ndërkohë që për këtë periudhë është paguar edhe nga Bashkia Rrubik. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM Nr.714, datë 22.10.2004 “Për veprimtarinë e jashtme dhe dhënien e dhuratave gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Milo Pano, Rajmond Koçi, Mirosh Bogdo, dhe Shefki Jaupi, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT